



INTERNATIONAL MONETARY FUND



Kumtesë për shtyp  
PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM  
9 qershor 2015

Fondi Monetar Ndërkombëtar  
Uashington, D.C. 20431 SHBA

### **FMN njofton për arritje të Marrëveshjes në nivel të Stafit me Kosovën lidhur me një Aranzhim të ri *Stand-By***

Kumtesat për shtyp të fundit të misionit zakonisht përfshijnë deklarata të ekipeve të FMN-së të cilat paraqesin gjetjet preliminare pas një vizite në një vend. Mendimet e shprehura në këtë deklaratë janë të stafit të FMN-së dhe nuk paraqesin medoemos mendimet e Bordit Ekzekutiv të FMN-së. Bazuar në gjetjet preliminare të këtij misioni, stafi do të përgatisë raportin i cili, nëse aprovet nga menaxhmenti, do t'i paraqitet Bordit Ekzekutiv për diskutim dhe vendimmarrje.

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në udhëheqje të z. Jacques Miniane, vizitoi Prishtinën gjatë periudhës 28 maj deri 9 qershor për të diskutuar me autoritetet lidhur me programin e reformës ekonomike, që do të mund të mbështetej me një Marrëveshje *Stand-By*.

Pas përmbjlljes së misionit, z. Jacques Miniane, Shefi i Misionit për Kosovën, dha këtë deklaratë sot në Prishtinë:

“Misioni arriti marrëveshje në nivel të stafit me autoritetet lidhur me një program ekonomik i cili do të mbështetej me një Marrëveshje *Stand-By* (MSB) me FMN-në, në një kohëzgjatje prej 22 muajsh. Qasja e propozuar do të kishte gjithsej SDR (*të drejta speciale të tërheqjes*) prej 147.5 milionë (rreth €185 milionë), apo 250 për qind të kuotës. Marrëveshja në nivel të stafit duhet të presë aprovimin e Menaxhmentit dhe Bordit Ekzekutiv të FMN-së. Shqyrtimi nga ana e Bordit Ekzekutiv pritet të bëhet deri në fund të muajit korrik.

“Rritja ekonomike në Kosovë ka mbetur relativisht e fortë dhe e qëndrueshme viteve të fundit, e nxitur pjesërisht nga remitancat e larta nga diaspora. Megjithatë, ekziston një konsensus i gjerë që nevojitet një rritje ekonomike më e lart për t'i afruar të ardhurat në nivele të vendeve fqinje dhe për të siguruar vende pune të cilësisë së lartë, për të cilat Kosova ka shumë nevojë. Për ta arritur këtë, autoritetet synojnë që t'i adresojnë hendeqet në infrastrukturë dhe shkathtësi, t'i adresojnë kostot e larta të punës, t'i heqin pengesat strukturore të kredithënies bankare, si dhe ta forcojnë mjedisin e biznesit. Veprimet vendimtare në këto fusha do ta ndihmojnë ekonominë e Kosovës që të arrijë një rritje të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse, të nxitur nga sektori privat dhe eksportet.

“Politikat fiskale do të kenë për qëllim që tembah nivelin mesatar të deficitit përgjatë periudhës së programit brenda kufizimit të rregullës fiskale prej 2 për qind. Kjo do ta mbajë borxhin publik në nivel të ulët dhe të qëndrueshëm në periudhën afatmesme. Rregullimet përkatëse do të bëhen me fokus që të frenohen ndikimet e vendimeve parazgjedhore të vitit të kaluar dhe të përmirësoj strukturën e buxhetit. Në veçanti, duke e mbajtur nivelin e pagave publike në vlera aktuale nominale, duke kufizuar shpenzimet në mallra dhe shërbime, si dhe duke shtuar përpjekjet për mbledhjen e të hyrave, do të krijohen hapësira të nevojshme për shpenzime prioritare të cilat nxisin rritjen ekonomike. Kombinimi i deficitit më të ulët dhe disbursimeve të Fondit do të ndihmojë që Qeveria ta kthejë mbulimin e parasë së gatshme në nivel të duhur.

“Bankat në Kosovë janë të kapitalizuara mirë, janë likuide dhe fitimprurëse, me përmirësim të cilësisë së aseteve. “Përpjekjet e autoriteteve gjithashtu do të jenë me fokus në forcimin e mëtejshëm të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sektorit financiar. Megjithatë, vazhdojnë të ekzistojnë disa sfida. Për shembull, pa valutë të saj, kapaciteti i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK-së) për të vepruar si huadhënës i opsionit të fundit në sistemin bankar është i kufizuar. Në këtë mënyrë, programi i ri i autoriteteve do t’i japë përparësi miratimit të një kornize të re për Asistencë Emergjente të Likuiditetit (*ELA*), në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Ngjashëm, programi do të sigurojë aplikim të plotë të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik në të gjitha bankat në Kosovë, gjë që do ta ndihmojë BQK-në t’i identifikojë dhe trajtojë më mirë rreziqet në sektorin financiar. Gjithashtu, do të bëhen përpjekje për të zhvilluar vegla të politikave të makroprudencës në BQK dhe për t’i institucionalizuar kapacitetet e autoriteteve për menaxhim të krizave.

“Reformat strukturore dhe institucionale, si dhe shpenzimet më të mëdha në infrastrukturë do të kenë për qëllim rritjen e aftësisë konkurruese të Kosovës dhe kapacitetit prodhues të saj, duke krijuar kushte për rritje më të lartë dhe më dinamike në periudhën afatmesme:

- Për ta ndërtuar infrastrukturën tejet të nevojshme, autoritetet planifikojnë që ta zgjerojnë klauzolën e rregullës fiskale për investime, për të lejuar projekte kapitale të financuara nga agjencitë multilaterale dhe bilaterale të zhvillimit. Kjo do të nxisë investime në fusha prioritare, siç janë infrastruktura dhe bujqësia. Do të parashihen procese për të siguruar transparencë dhe mbikëqyrje të fortë të këtyre projekteve të mëdha. Përveç kësaj, për të siguruar se borxhet mbesin në nivel të ulët dhe të qëndrueshëm, zgjerimi i klauzolës së investimeve në rregullën fiskale do të kërkojë që miratimi i këtyre projekteve të reja të kushtëzohet me mbajtjen e borxhit të përgjithshëm publik nën 30 për qind të BPV-së.
- Përderisa bankat kanë likuiditet të mjaftueshëm, rritja e kreditimit është pozitive por mund të jete me e larte, meqë pengesat strukturore, siç janë proceset joefikase gjyqësore dhe të mbledhjes kanë ndikim në normat e larta të kamatave (aktualisht rreth 750 bps) të cilat janë duke u ulur dhe kërkesat për hipotekë. Në kuadër të programit, autoritetet dhe stafi i Fondit do të kërkojnë mënyra plotësuese krahas përpjekjeve që tashmë ka filluar – siç janë hapat për uljen e ngarkesës së lëndëve të pazgjdhura gjyqësore dhe avancimit të

përdorimit të përmbauesve privatë për mbledhje – për t'i minimizuar pengesat e tilla strukturore.

- Për të siguruar se rritjet e ardhshme të pagave publike janë në hap me gjendjen e ekonomisë, autoritetet do të aplikojnë një rregull të re, e cila do të lidhë rritjen e ndarjes buxhetore për paga publike me tregues makroekonomikë të cilët do të mund të monitorohen lehtësisht. Kjo gjithashtu do të sigurojë që pagat e sektorit publik janë më të përafuara me ato të sektorit privat.
- Në fund, autoritetet kanë për qëllim që edhe me tutje të përmirësojnë mjedisin e të bërit biznes duke rritur nivelin e transparencës dhe duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë, për të tërhequr investime vendore dhe të huaja. Në këtë kuptim, autoritetet do të bëjnë hapa drejt prokurimit të centralizuar dhe e-prokurimit në qeveri, të cilat do të përmirësojnë mbikëqyrjen dhe kontrollin e sistemit të prokurimit.

“Misioni është takuar me Kryeministrin, Isa Mustafa, Guvernatorin e Bankës Qendrore, Bedri Hamza, Ministrin e Financave, Avdullah Hoti, si dhe zyrtarë të tjerë publikë, përfaqësues të sektorit privat, sindikatave të pavarura dhe partnerë ndërkombëtarë.” Stafi i FMN-e falenderon te gjithë bashkepunetoret per bashkpunimin e shkelqyeshem te hapur dhe miqesor.”